

QENDRA SHQIPTARE PËR KOMUNIKIM PUBLIK  
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

# UDHËZUES MBI RAPORTIMIN E NGJARJEVE DHE TEMATIKËS MBI TË MITURITNË TELEVISIONET SHQIPTARE



**UDHËZUES  
MBI RAPORTIMIN E NGJARJEVE DHE  
TEMATIKËS MBI TË MITURIT  
NË TELEVISIONET SHQIPTARE**

**RAMADAN ÇIPURI**

**Përgatiti**

**ALBAN TARTARI**

**Tiranë, 2017**



## PËRMBAJTJA

|   |    |
|---|----|
| RRETH UDHËZUESIT .....  | 5  |
| FËMIJËT DHE MEDIA .....   | 7  |
| PËRGJEGJËSIA DHE ROLI EDUKATIV I MEDIAS .....                                 | 9  |
| PËRDORIMI I IMAZHIT TË TË MITURVE ME QËLLIM<br>TËRHEQJEN E AUDIENCAVE .....   | 13 |
| KONVENTA MBI TË DREJTAT E FËMIJËS .....                                       | 14 |
| LEGJISLACIONI SHQIPTAR DHE TË DREJTAT E TË MITURVE ..                         | 16 |
| STANDARDET DEONTOLOGJIKE DHE ETIKE RRETH<br>TRANSMETIMEVE MBI TË MITURIT..... | 20 |

Botues: Qendra Shqiptare për komunikim Publik  
Adresa: Rr. Dritan Hoxha, Nd.92, Hyrja 41, Ap.25, Tiranë,  
Shqipëri  
Website: <http://acpc.al/>  
Email: [info@acpc.al](mailto:info@acpc.al)

Hartues të udhëzuesit: Ramadan Çipuri & Alban Tartari  
Redaktor: Rahim Ombashi  
Design & Layout: Erjet Muçollari  
ISBN:  
Tiranë, 2017

Copyright © - Qendra Shqiptare për Komunikim Publik

Udhëzuesi është përgatitur në kuadër të projektit të titulluar *“Respektimi i standardeve të Kodit të Transmetimit të AMA-s në raportimin e ngjarjeve dhe tematikës mbi të miturit, kundër nxitjes së intolerancës dhe gjuhës së urrejtjes”*, i zbatuar nga Qendra Shqiptare për Komunikim Publik me mbështetjen e Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA).

## RRETH UDHËZUESIT

Ky udhëzues është përgatitur për t'u ardhur në ndihmë profesionistëve të medias të cilët mbulojnë ngjarje, që kanë të bëjnë me fëmijët. Udhëzuesi përfshin një përshkrim të marrëdhënies që ekziston midis fëmijëve dhe medias, përgjegjësisë dhe rolit edukativ që media duhet të ketë në shoqëri, përdorimit të figurës së fëmijës nga mediat me qëllim tërheqjen e sa më shumë audiencave, parimet bazë të Konventës mbi të Drejtat e Fëmijëve, legjislacionit shqiptar mbi të drejtat e të miturve, si edhe standardeve deontologjike dhe etike rreth transmetimeve mbi të miturit të parashikuara në Kodin e Transmetimit të Autoritetit të Medieve Audiovizive.

Qëllimi i përgatitjes së këtij udhëzuesi është që të nxisë mbulim mediatik sa më profesional në lidhje me çështjet që prekin fëmijët.

Udhëzuesi është përgatitur në kuadër të projektit të titulluar *“Respektimi i standardeve të Kodit të Transmetimit të AMA-s në raportimin e ngjarjeve dhe tematikës mbi të miturit, kundër nxitjes së intolerancës dhe gjuhës së urrejtjes”*, i zbatuar nga Qendra Shqiptare për Komunikim Publik me mbështetjen e Autoritetit të Medieve Audiovizive (AMA).

Në kuadër të këtij projekti, Qendra Shqiptare për Komunikim Publik (ACPC), është angazhuar në realizimin e një fushate për ndërgjegjësimin dhe kualifikimin e ekipeve të gazetarëve të medias lokale dhe rajonale audiovizive me qëllimin kryesor për të përmirësuar raportimin dhe mbulimin e ngjarjeve dhe temave mbi mbrojtjen e të miturve, veçanërisht viktimat ndaj dhunës, si dhe nxitjen e sjelljeve intolerante në shkollë dhe jashtë saj, shmangien e gjuhës së urrejtjes etj., në respekt të standardeve dhe kërkesave të Kodit të Transmetimit të miratuar nga Autoriteti i Medieve Audiovizive, AMA.





## FËMIJËT DHE MEDIA

Fëmijët ekspozohen që në vitet e hershme të jetës së tyre ndaj përmbajtjeve televizive. Sot, familjet shqiptare e shohin televizorin si një mjet për të qetësuar fëmijët e tyre dhe për të mbushur kohën e tyre gjatë qëndrimit në shtëpi. Për këtë arsye, shumica e këtyre familjeve, zotëron pajtime në platformat kablore, të cilat kanë kanale të posaçme tematike për fëmijë.

Megjithatë vihen re disa probleme:

E para: Televizionet shqiptare prodhojnë shumë pak programe me përmbajtje për fëmijë. Nga një monitorim i kryer nga ACPC, maj 2017, vihet re një mungesë e programacionit për fëmijë në televizionet kryesore në vend. Kanalet si *Top Channel*, *Klan* dhe *Vizion Plus* duket e kanë pranuar faktin se fëmijët mund të ndjekin vetëm kanalet tematike që gjenden në platformat e tyre partnere, *Bang Bang* dhe *Cufo* në *Digitalb* dhe *Tring Tring* në platformën *Tring*. Po ashtu edhe televizioni publik ka shumë pak programe për fëmijë, të cilat ofrohen në kohë të ndryshme. Ashtu si edhe kanalet tematike, edhe transmetuesi publik ka zgjedhur të blejë produksione të huaja për fëmijë. Në këtë pikë, duket se është e nevojshme një strategji që do t'i shtynte televizionet të prodhojnë përmbajtje vendore, të cilat kontribuojnë në argëtimin, edukimin dhe udhëzimin e fëmijëve.

E dyta: Shpesh herë vihet re se mediet e përdorin figurën e fëmijës në promocionet e tyre. Figura e fëmijës shpesh është pjesë e atmosferës familjare që paraqitet në reklamat televizive, ku familja e lumtur është abonente e platformës përkatëse apo shikuese e kanalit përkatës.

E treta: Mediet audiovizive, i japin vend reklamave dhe mesazheve promocionale të korporatave dhe bizneseve të kategorive të ndryshme që përdorin figurën e fëmijës. Ka patur raste kur AMA ka ndaluar reklama të ndryshme të bizneseve, pasi përdornin në mënyrë abuzive figurën e fëmijëve. Në këtë pikë bizneset shpesh nuk pyesin për standardet etike dhe nuk konsultohen me televizionin që do ta

transmetojë reklamën. Nga ana tjetër, përballë këtij realiteti, televizionet shpesh nuk kërkojnë asnjë informacion lidhur me përmbajtjen e reklamës/videos promocionale, pasi kanë shqetësimin se mund ta humbin këtë kontratë reklame. Pra, në këtë pikë, bizneset janë më të fuqishme sesa televizioni që transmeton përmbajtjen përkatëse.

E katërta: Mediet audiovizive shpesh janë të pakujdesshme në përdorimin dhe publikimin e portretit dhe identitetit të fëmijëve, raste këto që nuk janë të pakta. Në shumë transmetime të tilla ka qenë vetë AMA që ka ndaluar transmetimin e videove dhe ka ndërmarrë masa (gjobë) ndaj televizioneve transmetuese. Në këtë kategori hyjnë edhe lajme të ndryshme apo tematika emisionesh. Televizionet duhet të bëjnë kujdes pasi shpesh fytyrat e fëmijëve jepen të pambuluara apo ofrohen edhe identitetet e tyre në lajme për të cilat ata në të ardhmen nuk do të donin të kishin lidhje. Në këtë pikë, standardet etike dhe ligjore duhet të respektohen në mënyrë rigorozë që nga kameramanët e gazetarët, që punojnë përditë me këto përmbajtje, dhe deri të drejtuesit më të lartë të televizioneve, që përcaktojnë çfarë do të transmetohet dhe çfarë jo.



## PËRGJEGJËSIA DHE ROLI EDUKATIV I MEDIAS

Media në tërësi dhe televizioni në veçanti janë pranuar gjerësisht si mjete të rëndësishme të edukimit të publikut. Debatet lidhur me këtë rol janë kryesisht për televizionin, që është media më e ndjekur në Shqipëri ndër mediat tradicionale. Shpesh vihen re diskutime lidhur me përmbajtjet mediatike, vlerën edukative dhe udhëzuese që ato kanë për publikun, veçanërisht për të rinjtë.

Në një shoqëri që ka ndryshuar rrënjësisht në këto 27 vjet, për shkak të ndryshimeve politike, ekonomike dhe social-kulturore, emigracionit dhe lëvizjeve demografike, televizioni merr një rol të madh.

Televizioni ndërton modele jetese të cilat i servir për publikun e gjerë duke u bazuar edhe të përsëritja apo ndërtimi i mesazheve, që janë të afërta në kuptime. Tregohet tashmë si një anekdotë fakti se si mijëra shqiptarë që lanë Shqipërinë në vitin 1990 duke emigruar në Itali, pritnin të gjenin atje “Italinë që kishin parë nga ekranet e TV italiane”, që i kishin ndjekur fshehurazi si një dritare lirie. Shqiptarët mendonin se atje i priste një jetë luksi ku gjithçka shkëlqente ashtu si në reklamat e kanaleve të RAI-t, Canale-5 apo Rete-4.

Të rinjtë ndjekin dhe mësojnë modele të ndryshme që ofrohen në programe, filma dhe përmbajtje të tjera si video-klipet muzikore. Qëndrimi, sjellja, veshja, ushqyerja e shumë zakone të tjera njerëzore, sot formësohen përmes medias. Ashtu siç u thotë edhe Edward Bernays amerikanëve në librin e tij *Propaganda* të vitit 1928, se ata mendojnë që veshjen e tyre e përcaktojnë vetë, por në fakt atë e përcakton një rrobaqepës (në kohën tonë quhet stilist) që jeton në Londër dhe që nuk ka asnjë lidhje me ta... Situata është akoma më kritike nëse mendohet në ditët e sotme, kur jemi të bombarduar përditë nga dhjetra ekranë: ekrani i celularit, tabletit, kompjuterit si dhe televizorët nga dhoma e gjumit e deri te lokalet dhe madje sheshet e mëdha të qyteteve tona. Pra, sot, shoqëria mëson më shumë përmes televizionit sesa përmes shkollës, një tendencë klasike që ka ndryshuar.

Diskutimet lidhur me aspektin edukativ të medias në Shqipëri mund të bazohen në disa tituj kryesorë siç janë:

1. Dhuna dhe ekstremizat
2. Politika
3. Seksi
4. Feja
5. Konsumerizmi

Etj.

Pra, në kohën që jetojmë, diskutimi më i madh po bëhet lidhet me dhunën. Shumë prindër reagojnë ndaj dhunës, që shpesh është e kudondodhur në kanalet televizive: që nga salla e Parlamentit e deri në një shtëpi të një katundi malor shqiptar. Rastet e dhunës që vijnë përmes atyre që quhen lajmet e kronikës së zezë, vihen re me një frekuencë të lartë në televizionet që synojnë të arrijnë sa më shumë audiencë. Pra, përmes logjikës televizive se lajmi i keq është ‘lajm i mirë’, shohim trajtimin deri në detaje të këtyre rasteve të dhunës. Media këtu mbyll sytë para faktit që, në të vërtetë, po ofron modele edhe për individë të tjerë të prirur drejt dhunës dhe ekstremizmit. Pra, ata, mund të mendojnë që “kur të tjerët i zgjidhin problemet përmes dhunës dhe ekstremizmit, përse ata të mos e bëjnë këtë gjë!” Rreziku shtohet kur këto përmbajtje ndiqen nga të miturit. Ata i marrin këto shabllone si modele. Ndonëse nuk ka një studim serioz, vihet re te të rinjtë që përvetësojnë një lloj sjelleje agresive e cila gjenerohet nga rrymat e reja muzikore, të cilat mbartin haptazi mesazhe reaguese dhe kryengritëse ndaj modeleve të ndryshme shoqërore. Pra, në Shqipëri, çështjet e trajtimit të dhunës si forma spektakli, (qoftë edhe duke u përpjekur t’i zgjidhësh këto probleme përmes emisioneve të së dielës), janë një burim i edukimit të gabuar të publikut.

Një element tjetër që duket se shton agresivitetin është politika. Në këto 27 vjet të pluralizmit politik, nga një shoqëri pa të drejta politike, është kaluar në ekstremin tjetër, atë të polarizimit të skajshëm të shoqërisë. Edhe në këtë pikë, politika, e cila duhej të formësonte

qeverisjen demokratike të vendit, duke përfituar pikërisht nga elementet demokratike kthehet në një element përçarjeje, përplasjeje, përjashtimi e madje shpesh edhe në dhunë.

Një problem tjetër, që bie ndesh me rolin edukativ të medias, është përdorimi i elementeve seksuale. Sot këto elemente mund të gjenden kudo; që nga reklamat televizive me nënkuptime, veshjet e prezantueseve, lajmet e quajtuara “rozë” lidhur me jetën private e deri te emisionet televizive “reality show” ku diskutohet hapur nëse çiftet në këtë program kryen apo jo marrëdhënie sekusale në transmetim të drejtëpërdrejtë! Seksizmi është kthyer në një element të fuqishëm të marketingut duke u shtyrë në këtë zonë edhe biznesin.

Një element tjetër delikat në shoqërinë shqiptare është trajtimi i fesë. Ky element shoqëror, ka raste që “demonizohet” duke u treguar si një e keqe e nga ana tjetër shpesh ka raste që tregohet si një kurë për problemet shoqërore. Media shqiptare ka shumë pak informacione dhe përgatitje lidhur me çështjet teologjike në tërësi dhe besimet e vaçanta të përqafuara apo aplikuar nga shqiptarët, ose edhe lidhur me faktin që një pjesë e shoqërisë nuk pranon fare të flasë për fenë.

Këta janë veç pak shembuj se si televizionet sot në Shqipëri, i trajtojnë këto tema vetëm nga perspektiva e tërheqjes së audiencës. Kjo i gjan atij supermarketit që nuk i bën asnjë përshtypje se mund të blesh tonelata me sheqerna të përpunuara dhe t’i hash, pra të sëmuresh, pa për supermarketin e rëndësishme është të shesë mallin brenda datës së skadencës! Po ashtu edhe media shqiptare, synon të shesë “mallin” e saj pa i skaduar koha, duke marrë sa më shumë vëmendje e shikueshmëri, pa mbajtur asnjë përgjegjësi se çfarë ndikimi ka ky mall mbi miliona vetë që po e konsumojnë. Televizioni e trajton shikuesin si një “super-njeri” që mund të gëlltisë çdo lloj përmbajtjeje pa rrezikuar asnjë, me një lehtësi mahnitëse. Në fakt, nuk është kështu. Asnjë shikues nuk është “super-njeri” dhe s’ka fuqi të mbinatyrshme, aq më tepër kur bëhet fjalë se përballë ekranit mund të gjesh të mitur pa fund, të cilët janë akoma më shumë të predispozuar për t’u ndikuar nga mesazhi mediatik.

Më sipër u trajtuan disa elemente, por nuk duhet harruar se televizionet kanë për detyrë të edukojnë publikun me programe argëtuese, edukative, mobilizuese në të mirë të shoqërisë në tërësi dhe individit në veçanti. Këtu merr rëndësi televizioni publik, që duhet të vijojë të prodhojë përmbajtje në këtë kontekst, pa lënë mënjanë tërësisht konkurrencën në treg dhe cilësinë e programeve, por edhe duke mos komercializuar gjithçka. Programet edukativo-kulturore, gjuhësore, historike, argëtuese etj. kanë vlera të çmuara dhe të mos harrojmë që këto programe pasi marrin vendin e tyre në transmetimet televizive, përhapen me shpejtësi drejt platformave të videove në internet. Tashmë arkivi i përmbajtjeve televizive nuk janë më kasetat në raftet e pluhurosura, por prezantimi i tyre i pafundmë në platformat e videove në internet dhe në medien sociale.



## **PËRDORIMI I IMAZHIT TË TË MITURVE ME QËLLIM TËRHEQJEN E AUDIENCAVE**

Në kapitullin e këtij punimi lidhur me median dhe fëmijët, u evidentua se shpesh figura e fëmijës përdoret si nga ana e televizioneve, po ashtu edhe nga ana e bizneseve për të bindur audiencat konsumatore që të blejnë produktet përkatëse të reklamuar. Fëmija është pjesë e një strukture të ndërtuar me kujdes dhe vendoset shpesh brenda një familjeje të lumtur. Këtu, luhet me imazhin e familjes së plotë e të lumtur dhe lihet të nënkuptohet se nëse do të blihet produkti në fjalë, lumturia e kësaj familjeje dhe veçanërisht lumturia dhe kënaqësia e fëmijëve do të shtohet.

Bashkimi i figurës së fëmijës me produkte të ndryshme është abuziv dhe synon të drejtojë logjikën e blerjeve dhe konsumit të fëmijëve si dhe familjeve të tyre. Shpesh, në reklama të ndryshme, shënjestrohen vetë fëmijët. Reklamat janë më së shumti për produkte ushqimore si sheqernat e përpunuar. Askush nuk vendos një shënim që përdorimi pa kriter i këtyre nënprodukteve të sheqerit ndikon negativisht në shëndetin e fëmijëve në planin afatgjatë. Synohet shitja e momentit, synohet sa më shumë përfitim ekonomik. Reklamat shkojnë deri në absurd duke vendosur fëmijët që të thonë shprehje krejt të palogjikshme si “dua babin dhe mamin, por më shumë dua lëngun X”. Pra, bëhet një paralelizëm mes produktit dhe familjes, dashurisë prindërore etj..

Nga ana tjetër, shënjestrohen prindërit. Duke luajtur me efektet e dhembshurisë prindërore (të njohura tashmë nga shkencëtarët e psikologjisë), synohet bindja e këtyre prindërve se blerja e produkteve të reklamuar do të shtojnë lumturinë e fëmijëve dhe rrjedhimisht kënaqësinë familjare dhe harmoninë në familje. Një reklamë e një kompanie celulare me foshnjën, që qan sa herë i hiqet nga dora celulari, është një tregues për këtë element. Kjo reklamë u ndalua dhe u hoq prej transmetimit nga AMA.

## KONVENTA MBI TË DREJTAT E FËMIJËS

Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës, e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara më 20 nëntor 1989, parashikon se shtetet palë angazhohen të respektojnë të drejtat e përmendura në këtë Konventë dhe t'ia garantojnë ato çdo fëmije, që përfshihet në juridiksionin e tyre, pa asnjë lloj dallimi, pavarësisht nga raca, ngjyra, gjinia, gjuha, feja, opinioni politik ose çdo opinion tjetër, nga origjina kombëtare, etnike ose shoqërore, pasuria, paaftësia, prejardhja familjare apo çdo gjendje tjetër e fëmijës apo prindërve të tij ose përfaqësuesve të tij ligjorë.



Ndër të tjera, me ratifikimin e kësaj Konvente, shtetet palë marrin të gjitha masat e duhura, me qëllim që fëmija të jetë efektivisht i mbrojtur nga të gjitha format e diskriminimit ose ndëshkimit, për shkak të pozitës, veprimtarive, opinioneve të shprehura ose bindjeve të prindërve të tij, të përfaqësuesve të tij ligjorë ose të anëtarëve të familjes së tij.

Konventa për të Drejtat e Fëmijëve përfaqëson një grupim normash dhe detyrimesh, që kanë për qëllim të pranohen në mbarë botën, të cilat mbrojnë të drejtat e fëmijëve. Komuniteti ndërkombëtar, përmes këtij



teksti, bëri të njohur se qeniet njerëzore nën 18 vjeç duhet dhe kanë të drejtën e një mbrojtjeje të veçantë.

Më 19 dhjetor 2011 Asambleja e Përgjithshme e OKB-së miratoi Protokollin e Tretë Fakultativ të Konventës për të Drejtat e Fëmijës, duke krijuar një procedurë individuale të ankimimit, në rastet e shkeljeve të të drejtave të fëmijëve. Protokollin e Tretë Opsional të Konventës për të Drejtat e Fëmijëve ka hyrë në fuqi në prill 2014.

Sipas Konventës, të drejtat në fjalë mund të përmbliken në dhjetë pika kryesore:

1. Të gjithë fëmijët dhe të rinjtë kanë të drejta të barabarta. Asnjë fëmijë apo i ri, nuk duhet të dëmtohet për shkak të gjinisë, ngjyrës, gjuhës apo besimit të tij.
2. Fëmijët dhe të rinjtë kanë të drejtë të gëzojnë shëndet të plotë dhe t'u jepet kujdesi maksimal shëndetësor dhe mjekësor.
3. Fëmijët dhe të rinjtë kanë të drejtë për arsim fillestar falas. Përveç kësaj, atyre duhet t'u mundësohet edhe arsimimi i mëtejshëm.
4. Fëmijët dhe të rinjtë kanë të drejtën për pushim, kohë të lirë, lojë dhe pjesëmarrje në aktivitete kulturore dhe artistike.
5. Fëmijët dhe të rinjtë kanë të drejtën e informimit, shprehjes së mendimit të tyre dhe të drejtën për t'u dëgjuar.
6. Fëmijët dhe të rinjtë kanë të drejtën për një edukim të mirë. Prindërit apo edukatorët e tjerë nuk duhet të përdorin dhunë; keqtrajtimi dhe keqpërdorimi është i ndaluar.
7. Fëmijët dhe të rinjtë kanë të drejtën e mbrojtjes dhe ndihmës së veçantë në luftë dhe gjatë arratisjes.
8. Fëmijët dhe të rinjtë kanë të drejtën e mbrojtjes nga puna shfrytëzuese dhe keqpërdorimi seksual.
9. Fëmijët dhe të rinjtë kanë të drejtë të jetojnë me prindërit e tyre dhe të mbajnë kontaktin me të dy prindërit, nëse ata jetojnë të ndarë.
10. Fëmijët dhe të rinjtë e gjymtuar kanë të drejtën e ndihmës dhe përkrahjes së veçantë, si dhe të pjesëmarrjes aktive në jetën shoqërore.

## LEGJISLACIONI SHQIPTAR DHE TË DREJTAT E TË MITURVE

Nga rënia e regjimit totalitar e deri më sot, legjislacioni shqiptar për të drejtat e fëmijëve është përmirësuar ndjeshëm, duke respektuar e garantuar të drejtat e parashikuara në Konventën për të Drejtat e Fëmijëve, por edhe në çdo angazhim tjetër të vendit në përpjekjet e përbashkëta të vendeve të zhvilluara.



Konventa për të Drejtat e Fëmijëve u nënshkrua nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë në Shkurt të vitit 1992 dhe hyri në fuqi në mars të po këtij viti.

Përveç Konventës së të Drejtave të Fëmijëve, Shqipëria ka nënshkruar edhe Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Konventën e Këshillit të Evropës “Për mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi seksual dhe abuzimi seksual” etj.

Nisur nga legjislacioni shqiptar, fëmijët gëzojnë mbrojtje të veçantë nga shteti. Ai mbron të drejtat pasurore, të drejtat e fëmijëve që punojnë, të drejtat e fëmijës në konflikt me ligjin, të drejtat për përkrahje shoqërore etj.

Janë një sërë normash ligjore ato të cilat përcaktojnë të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve. Disa prej tyre janë si më poshtë:

Kodi Civil parashikon mbrojtjen e të drejtave pasurore të fëmijës. Sipas këtij Kodi, mund të trashëgojë pronë fëmija që në kohën e leximit të testamentit është gjallë.

Kodi i Punës parashikon moshën 16-vjeçare si minimale të pranimit në punë për fëmijët, siç edhe në disa raste vlerëson moshën 14-vjeçare si të lejueshme për punë të konsideruara si të lehta.

Kodi Penal përshkruan të drejtat e fëmijëve në konflikt me ligjin, sipas të cilit fëmija ka përgjegjësi penale kur mbush 14 vjeç për veprat penale dhe 16 vjeç për kundravajtjet penale, për të cilat nuk dënohet me heqje të lirisë. Duhet theksuar fakti se fëmijët trajtohen në mënyrë të veçantë gjatë procesit gjyqësor. Ata marrin ndihmë të veçantë juridike dhe psikologjike.

E rëndësishme mbetet marrëveshja e Ministrisë së Drejtësisë dhe e Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve, sipas së cilës, edhe kur dënohen me heqje të lirisë, fëmijët vazhdojnë të arsimohen.

Kodi i Familjes është një tjetër bazë ligjore që ngarkon prindërit, organet kompetente dhe gjykatat që në vendimet dhe veprimtaritë e tyre duhet të kenë si konsideratë parësore interesin më të lartë të fëmijës.

Ligji “Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës” përcakton të drejtat dhe mbrojtjen që gëzon çdo fëmijë, mekanizmat dhe autoritetet përgjegjëse, që garantojnë me efektivitet ushtrimin, respektimin, promovimin e këtyre të drejtave, si dhe mbrojtjen e veçantë të fëmijës

Ky ligj ka për qëllim:

- a) mbrojtjen e fëmijës, nëpërmjet plotësimit të kuadrit ligjor e institucional, në zbatim të Kushtetutës, të Konventës së Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Fëmijës, të akteve ndërkombëtare që veprojnë në këtë fushë, si dhe të legjislacionit në fuqi;
- b) parashikimin e parimeve bazë ku mbështeten politikat kombëtare për të drejtat e fëmijës, mekanizmat efikase, autoritetet përgjegjëse në nivel qendror e vendor dhe kompetencat e tyre në fushën e të drejtave dhe të mbrojtjes së fëmijës;

- c) garantimin e mirëqenies dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së fëmijës, duke promovuar e mundësuar zhvillimin e tyre në shoqëri, ndihmën dhe përkujdesin efektiv për fëmijën, shëndeti dhe mirëqenia e të cilit janë në rrezik;
- d) marrjen e masave për t'i siguruar fëmijës ushtrimin e të drejtave, në përputhje me zhvillimin e personalitetin, bazuar në interesin më të lartë të tij;  
marrjen e masave për të siguruar jetesën, mbijetesën dhe zhvillimin e fëmijës;
- e) sigurimin e bashkëpunimit ndërmjet strukturave dhe autoriteteve qendrore e vendore, si dhe organizatave që mbrojnë të drejtat e fëmijës;
- f) parashikimin e mekanizmave efektive dhe funksionimin e institucioneve të ngarkuara me marrjen e masave konkrete për promovimin, respektimin e mbrojtjen e të drejtave të fëmijës, si dhe për ngritjen e një sistemi të integruar e funksional të mbrojtjes së fëmijës, për parandalimin dhe përgjigjen efikase ndaj të gjitha formave të dhunës, abuzimit, shfrytëzimit e neglizhimit.


Çështjet që kanë të bëjnë me arsimin parashikohen në ligjin “Për sistemin arsimor parauniversitar”, sipas të cilit të gjithë fëmijët e moshës 6-vjeçare në Republikën e Shqipërisë duhet të fillojnë arsimin bazë, i cili zgjat jo më pak se 9 vjet. Nxënësi është i detyruar të ndjekë arsimin bazë deri në moshën 16 vjeç. Në institucionet arsimore publike shteti u siguron nxënësve falas mjediset mësimore, bazën materiale të tyre dhe personelin mësimdhënës.

Ligji “Për mbrojtjen e të miturve nga përdorimi i alkoolit” ka si qëllim parandalimin e pasojave shëndetësore nga konsumi i alkoolit, nëpërmjet përdorimit të pijeve alkoolike nga të miturit. Objekti i ligjit është ndalimi i përdorimit të pijeve alkoolike nga të miturit. Në nenin 3 të këtij ligji, “Konsiderohet reklamë e pijeve alkoolike çdo formë komunikimi, udhëzimi apo veprimi tregtar i ngjashëm me to dhe që në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo ndikon në nxitjen e përdorimit të alkoolit.”

Ligji “Për procedurat e birësimit dhe komitetin shqiptar të birësimit” përcakton procedurat e birësimit, si dhe organizimin, funksionimin e detyrat e Komitetit Shqiptar të Birësimit.


Ligji “Për statusin e jetimit” përcakton kriteret për fëmijët që fitojnë këtë status, si edhe asistencën e shtetit në mbështetje të tyre.

Një hapësirë e rëndësishme për fëmijët është parashikuar edhe në “Kodin e transmetimit të Autoritetit të Medieve Audiovizive”, i cili përcakton qartë normat dhe standardet që duhen ushtruar në raportimet dhe transmetimet mediatike të cilat bëhen në lidhje me të miturit.



## STANDARDET DEONTOLOGJIKE DHE ETIKE RRETH TRANSMETIMEVE MBI TË MITURIT

Kodi i Transmetimit të Autoritetit të Medieve Audiovizive parashikon një seri normash dhe standardesh që duhen respektuar nga Ofruesit e Shërbimit Mediatik Audioviziv (OSHMA) kur raportojnë mbi çështje që kanë të bëjnë me fëmijët. Në seksionin e parë të Kodit, parashikohen parimet themelore që duhen respektuar, të cilat janë si më poshtë:



### SEKSIONI 1

#### PARIMET THEMELORE

*Parimet themelore që përbëjnë bazën e zhvillimit të veprimtarisë audiovizive, e cila mbështetet në garantimin e lirisë dhe të pluralizmit të mjeteve të komunikimit audioviziv, janë si më poshtë vijon:*

- 1.1. Operatorët e shërbimit mediatik audioviziv, gjatë zhvillimit të veprimtarisë së tyre, garantojnë dhe respektojnë lirinë e shprehjes dhe të drejtën e informimit.

- 1.2. Veprimtaria e transmetimeve audiovizive respekton rendin kushtetues, sovranitetin dhe integritetin kombëtar.
- 1.3. Transmetimet audiovizive respektojnë personalitetin, dinjitetin, të drejtat e liritë e tjera themelore të njeriut.
- 1.4. Veprimtaria e transmetimeve audiovizive respekton në mënyrë të veçantë të drejtat, interesat dhe kërkesat morale e ligjore për mbrojtjen e të miturve.
- 1.5. Transmetimet audiovizive nuk duhet të nxisin intolerancën ose të justifikojnë dhunën ndërmjet shtetasve.
- 1.6. Transmetimet audiovizive duhet të respektojnë pluralizmin dhe paanësinë në politikat editoriale.
- 1.7. Veprimtaria e transmetimeve audiovizive respekton normat morale dhe etike të shoqërisë, si dhe kërkesat e deontologjisë së profesionit të gazetarit.
- 1.8. Në transmetimet audiovizive respektohen të drejtat e autorit dhe të drejta të lidhura me të si dhe standardi letrar i gjuhës shqipe.
- 1.9. Veprimtaria e transmetimeve audiovizive respekton veçanërisht të drejtat e personave me aftësi të kufizuar.
  - 1.10. Transmetimet audiovizive respektojnë privatësinë dhe garantojnë të drejtën e përgjigjes.
- 1.11. Transmetimet audiovizive realizojnë një larmi përmbajtjeje e informacioni duke respektuar lirinë e konkurrencës dhe duke shfrytëzuar mundësitë e zhvillimit teknologjik.
- 1.12. Transmetimet audiovizive të të gjitha llojeve respektojnë të drejtën e barazisë dhe mos diskriminimit për çdo shkak të mbrojtur nga legjislati shqiptar.
- 1.13. Transmetimet audiovizive nuk duhet të përmbajnë mesazhe të dëmshme, nxitje të krimit, dhunës fizike apo urrejtjes.
- 1.14. Transmetimet audiovizive që përmbajnë elemente të pornografisë apo dhunës së skajshme duhet t'u nënshtrohen rregullave të veçanta të një sistemi kontrolli, si ai i aksesit të kushtëzuar apo programeve të kriptuara.

- 1.15. Operatorët e shërbimit mediatik audioviziv duhet të jenë të hapur ndaj ideve, opinioneve, tendencave e kahjeve të ndryshme politike, shoqërore, kulturore e fetare.
- 1.16. Transmetimet audiovizive duhet të ruajnë e të promovojnë veçanësitë etnike dhe trashëgiminë kulturore, artistike e mjedisore në nivel kombëtar e lokal.
- 1.17. Transmetimet audiovizive duhet të promovojnë dhe të mbrojnë mirëqenien shëndetin e zhvillimin harmonik moral e fizik të të miturve.

Seksioni i pestë i përkushtohet tërësisht standardeve të kërkuara në lidhje me “Fëmijët në Transmetimet Audiovizive”. Kriteret dhe standardet që duhen respektuar janë si më poshtë:

## **FËMIJËT NË TRANSMETIMET AUDIOVIZIVE**

*Çdo fëmijë gëzon të drejtën e marrjes së një informacioni të përshtatshëm, si dhe të drejtën e fjalës, të shprehjes së mendimit dhe të marrjes në konsideratë si një individ me të drejta të patjetërsueshme. Zbatimi i një tërësie parimesh e rregullash, që i japin përparësi interesit të lartë të fëmijës dhe që vendosin në qendër fëmijën, është më se i domosdoshëm. Parime të tjera bazë janë garantimi i mbrojtjes së fëmijëve, e drejta absolute e fëmijës për privatësi, luftimi i paragjykimeve, diskriminimit dhe stereotipeve në shoqëri, vërtetësia dhe saktësia e konfirmuar e raportimit të ngjarjeve që lidhen me fëmijët, e drejta e pjesëmarrjes së fëmijëve si dhe parimi shumë i rëndësishëm që e vendos median në shërbim të fëmijëve.*

*Për realizimin dhe zbatimin e parimeve të mësipërme nga Ofruesit e Shërbimit Mediatik Audioviziv (OSHMA) duhet të mbahen parasysh rregullat që vijojnë:*

## **IDENTIFIKIMI I FËMIJËS**

- 5.1. OSHMA-të duhet të shmangin çdo raportim apo transmetim, që çon direkt apo indirekt në identifikimin me pamje dhe zë, me gjeneralitete,



adresë apo përshkrues të çdo fëmije që mund të jetë ose është viktimë, dëshmitar, i hetuar, i akuzuar apo deklaruar fajtor për kryerjen e një veprë penale.

- 5.2. Duhet shmangur çdo raportim apo transmetim që çon direkt apo indirekt në identifikimin e çdo fëmije që mund të jetë ose është përfshirë në një ngjarje të rëndë familjare.
- 5.3. Në rastet e parashikuara në pikat 5.1 dhe 5.2 më sipër, duhet përdorur teknologjia e përshtatshme që mundëson fshehjen e identitetit me pamje ose zë të fëmijës
- 5.4. Kujdes duhet treguar edhe me raportimin e transmetimin e palëve të treta jo-fëmijë, kur kjo mund të çojë në identifikimin direkt ose indirekt të fëmijës sipas pikave 6.1<sup>1</sup> dhe 6.2<sup>2</sup> të sipër përmendura.
- 5.5. Pamjet apo imazhet e fëmijëve duhen marrë në mënyrë të ndershme dhe të drejtë dhe kurdo që është e mundur, ato duhen marrë me dijeninë dhe pëlqimin e vetë fëmijës dhe në rast të kundërt ato duhen marrë me pëlqimin e prindërve të tij ose kujdestarit ligjor të fëmijës, pasi t'u jetë shpjeguar qëllimi.
- 5.6. OSHMA-të duhet të shmangin transmetimin e fotove dhe imazheve degraduese të fëmijëve dhe në vend të tyre duhet stimuluar transmetimi i fotove dhe imazheve pozitive të fëmijëve.
- 5.7. Duhet shmangur botimi dhe transmetimi i çdo fotoje dhe imazhi fëmije me nuancë seksuale apo që paraqet fëmijën në pozicione të papërshtatshme.
- 5.8. Filmimi i fëmijëve duhet kryer në mjedise publike në praninë e përfaqësuesit ligjor të fëmijës ose një personi të caktuar prej tij.
- 5.9. OSHMA-të duhet të kenë rregulla të forta për arkivimin dhe shpërndarjen e materialeve dhe filmimeve me fëmijë, duke kufizuar dhe

---

<sup>1</sup> OSHMA-të duhet të luajnë një rol të rëndësishëm për të dhënë një imazh të respektuar të personave me aftësi të kufizuar në transmetimet audiovizive.

<sup>2</sup> OSHMA-të kanë për detyrë të tërheqin vëmendjen dhe të sensibilizojnë shoqërinë dhe institucionet e ndryshme për përgjegjësinë ndaj personave me aftësi të kufizuar.

parandaluar mundësitë e abuzimit me këto materiale. Materialet që blihen OSHMA –të (dokumentar, etj) respektojnë për sa është e mundur sa më sipër.

## **INTERVISTIMI FËMIJËS**

- 5.10. Intervistimi i fëmijëve duhet të bëhet me praninë ose të paktën me dijeninë e përfaqësuesit të tij ligjor apo një personi të caktuar prej tij.
- 5.11. Fëmijës si dhe përfaqësuesit ligjor duhet t'i shpjegohet paraprakisht qëllimi i intervistës, si dhe përdorimi i mundshëm i saj. Si për fëmijën, ashtu edhe për përfaqësuesin ligjor, duhet të respektohet e drejta e tyre për të mos pranuar të intervistohen.
- 5.12. Në rast se përfaqësuesi ligjor refuzon intervistimin e fëmijës, intervistimi mund të kryhet vetëm nëse fëmija insiston të intervistohet dhe gazetari ka një arsye konkrete të mendojë që intervistimi i shërben interesit të fëmijës.
- 5.13. Në asnjë rast gazetari nuk ushtron presion, bën pretime apo jep dhurata fëmijës apo përfaqësuesit të tij ligjor me qëllim mundësimin e intervistimit.
- 5.14. Nëse është e nevojshme, gjatë intervistimit të fëmijës, gazetari mund të kërkojë asistencën e një psikologu apo punonjësi social të specializuar.
- 5.15. Intervista duhet të zhvillohet në një mjedis të përshtatshëm ku fëmija ndihet i lirë dhe jo nën presion. Duhet të shmangen intervistimet dhe filmimet e gjata që lodhin dhe ndikojnë negativisht tek fëmijët si dhe përsëritja pa arsye të forta e intervistimit dhe filmimit të të njëjtit fëmijë.
- 5.16. Pyetjet duhet të jenë të qarta dhe të drejtpërdrejta dhe nuk duhet t'i sugjerojnë përgjigjen fëmijës.
- 5.17. Duhet të shmangen pyetjet ose komentet paragjyquese, të rrezikshme për fëmijën, ose ato që i sjellin ndërmend ngjarje traumatike.
- 5.18. Fëmijët nuk duhet të detyrohen të sillen sipas udhëzimeve të dhëna nga gazetari ose media, ata duhen nxitur vetëm të jenë vetvetja.

- 5.19. Nëse gjatë intervistimit gazetari vihet në dijeni për një vepër penale të kryer ndaj fëmijës apo që rrezikon fëmijën, gazetari duhet të njoftojë menjëherë organet përkatëse.
- 5.20. Në rast se gjatë intervistimit gazetari vihet në dijeni për fakte, bërja publike e të cilave mund të rrezikojnë jetën, shëndetin apo mirëqenien e fëmijës, intervista apo kjo pjesë e saj nuk duhet të transmetohet.

### **REKLAMAT DHE FËMIJËT**

- 5.21. OSHMA-të nuk duhet të transmetojnë reklama që mund të dëmtojnë zhvillimin fizik, mendor ose moral të të miturve.
- 5.22. OSHMA-të nuk duhet të transmetojnë në programet për fëmijë reklamat e kategorive të veçanta të ushqimeve dhe pijeve që konsiderohen se janë të dëmshme për të miturit, veçanërisht ato me përmbajtje të lartë yndyre, sheqeri, kripe etj.
- 5.23. OSHMA-të duhet të kontrollojnë përmbajtjen e reklamave dhe promocionit të programeve, sidomos të reklamave me dhe për fëmijët.
- 5.24. Reklamat nuk duhet t'i paraqesin fëmijët në situata e qëndrime të dhunshme e të rrezikshme, agresive apo autoagresive.
- 5.25. Reklamat nuk duhet të paraqesin fëmijë duke konsumuar alkool, duhan apo substanca të tjera të dëmshme.
- 5.26. Fëmijët nuk duhet të paraqiten drejtpërdrejt në blerjen e produkteve që reklamohen, pasi mund të abuzohet me besimin dhe mungesën e përvojës së tyre.
- 5.27. OSHMA-të duhet të hartojnë dhe zbatojnë kode sjelljeje në lidhje me komunikimet e papërshtatshme me natyrë tregtare në transmetimet e tyre.

### **PROGRAMET KULTURORE ARGËTUESE, FILMAT DHE FËMIJËT**

- 5.28. OSHMA-të nuk lejohet të transmetojnë programe që mund të dëmtojnë seriozisht zhvillimin fizik, mendor ose moral të të miturve, në

veçanti filma apo programe që përmbajnë pornografi ose që paraqesin skena dhune të skajshme dhe artificiale.

- 5.29. OSHMA-të në programet kulturore e argëtuese, veçanërisht në paraqitjen e sjelljeve të dhunshme dhe seksuale, duhet të tregojnë kujdesin e duhur ndaj ndjeshmërisë së publikut dhe efekteve të programeve të tilla në zhvillimin moral, mendor e fizik të të miturve.
- 5.30. OSHMA-të duhet të planifikojnë në fasha orare të përshtatshme programe të posaçme kulturore argëtuese për fëmijët.
- 5.31. OSHMA-të, duhet të zbatojnë me përpikëri kërkesat etiko – morale dhe të mbrojnë të drejtat e fëmijëve në programet kulturoro-argëtuese për fëmijë.
- 5.32. OSHMA-të duhet të zgjedhin orarin e transmetimit të programeve që të mos dëmtojnë zhvillimin mendor, fizik apo moral të fëmijëve, ose të marrin ndonjë masë tjetër teknike, që fëmijët të mos i shikojnë ose dëgjojnë të tilla transmetime. (Ora kufi 21.00 – 06.00)
- 5.33. Kur programe me përmbajtje që mund të dëmtojë fëmijët transmetohen në formë të hapur, ato duhet të paraprihen nga një paralajmërim akustik ose të identifikohen nga prezenca e një simboli viziv gjatë gjithë kohëzgjatjes së tyre.
- 5.34. OSHMA-të duhet të mbajnë parasysh shkallën e dëmit së shkaktuar nga paraqitja e ndonjë lloj materiali që dëmton fëmijët, në programe përgjithësisht ose në programe të një natyre të caktuar.
- 5.35. OSHMA-të duhet të mbajnë parasysh kërkesat e fëmijëve ndaj transmetimeve audiovizive në sasi e cilësi, si për të shmangur rrezikun e varësisë së fëmijës ndaj televizionit ashtu edhe për të mos imituar modelet televizive.
- 5.36. OSHMA-të duhet të trajtojnë me respekt, dinjitet e profesionalizëm të gjithë fëmijët që marrin pjesë në programet audiovizive.
- 5.37. OSHMA-të nuk duhet të lejojnë në programet e tyre përdorimin e fëmijëve me probleme patologjike apo me aftësi të kufizuara për qëllime propagandistike apo për çdo qëllim tjetër që abuzon me të drejtat e tyre,

përveçse për qëllime në interes të fëmijëve dhe me miratimin e përfaqësuesit ligjor.

- 5.38. OSHMA-të janë të detyruara të vendosin shenjat paralajmëruese për mbrojtjen e fëmijëve, veçanërisht në filmat dhe programet me përmbajtje e skena problematike.
- 5.39. OSHMA-të duhet të tregojnë kujdes të veçantë për gjuhën dhe komunikimin etik në programet argëtuese, në spektaklet e organizuara me dhe për fëmijët.
- 5.40. OSHMA-të, në rastin e Shërbimeve Mediatike Audiovizive në bazë të kërkesës (on demand), duhet të transmetojnë në formë të koduar programet që mund të dëmtojnë rëndë zhvillimin fizik, mendor ose moral të të miturve, kodim që duhet të sigurojë mos marrjen e tyre nga të miturit në kushte të zakonshme.
- 5.41. Në programet kulturore e argëtuese për fëmijët nuk duhet të përdoren terma të cilat nxisin qëndrime paragjyquese.

## **SHENJAT PARALAJMËRUESE PËR MBROJTJEN E FËMIJËVE NË PROGRAMET AUDIOVIZIVE**


- 5.42. Për programet që transmetohen në fashën e orëve 19.00 – 22.30, bëhet i detyrueshëm përdorimi i shenjave paralajmëruese për programet që cenojnë e dëmtojnë fëmijët.
- 5.43. OSHMA-të duhet të transmetojnë programet e përcaktuara në pikën 5.41 më sipër, me shenjë përkatëse, e cila duhet të shfaqet në ekran në një vend të dukshëm, me ngjyrë të qartë e të dallueshme.
- 5.44. OSHMA-të duhet të përgatisin transmetimin e filmave apo programeve të përcaktuara në pikën 5.41 me shenjë përkatëse (kur programi vetë nuk e përcakton) duke u mbështetur në vizionimim paraprak të programit, sipas kritereve, standardeve e rregullave të Kodit të Transmetimit.
- 5.45. Shfaqja e shenjës paralajmëruese në ekran bëhet menjëherë me fillimin e programit apo filmit dhe e shoqëron atë gjatë gjithë kohës së

transmetimit. Shenja paralajmëruese rishfaqet para dhe pas të gjitha ndërprerjeve të programit në vijim, deri në përfundim të tij.

5.46. Llojet e shenjave paralajmëruese, që do të përdoren nga OSHMA-të do të jenë tri:

- a) Shenjë paralajmëruese me ngjyrë të kuqe, për programe ose filma, që nuk duhet të ndiqen nga fëmijët, të cilat transmetohen vetëm pas orës 21.00, me skena të rënda dhune psikologjike e fizike, me skena seksi, me keqpërdorim të gjuhës, fjalorit dhe etikës së komunikimit.
- b) Shenjë paralajmëruese me ngjyrë të verdhë, për programe ose filma, të cilat fëmijët duhet t'i ndjekin të shoqëruar nga të rriturit.
- c) Shenjë paralajmëruese me ngjyrë të gjelbër, për programe ose filma me përmbajtje që mund të ndiqen nga të gjithë, përfshi edhe fëmijët.

5.47. OSHMA-të mund të përdorin forma të ndryshme të zgjidhjes grafike për shenjat paralajmëruese, por ngjyra dhe qartësia e shenjës janë elemente të pandryshueshme dhe të detyrueshme për të gjithë.





QENDRA SHQIPTARE PËR KOMUNIKIM PUBLIK  
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

*Botues: Qendra Shqiptare për komunikim Publik  
Tiranë, 2017*